



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI B

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Gjeografi bërthamë

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15a	15b	16	17	18	19	20
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Cili nga mineralet e mëposhtëm është më i forti sipas Shkallës së Mosit?

1 pikë

- A) Gipsi
- B) Talku
- C) Kuarci
- D) Diamanti

2. Cila nga alternativat e mëposhtme kategorizohet si rajon fizik?


1 pikë

- A) Amerika Latine
- B) Alpet e Evropës
- C) Lindja e Mesme
- D) Bota Arabe

3. Në një ditë pa erë, temperatura e ajrit jashtë shtëpisë është 10°C , ndërsa brenda shtëpisë është 18°C . Cila nga figurat e paraqet në mënyrë të qartë modelin e qarkullimit të ajrit, nëse dritarja e shtëpisë është e hapur?

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



4. Figura është marrë nga një satelit i motit nëpërmjet rrezeve infra të kuqe. Çfarë tregon zona me pjesën më të errët?

1 pikë

- A) Mbulesën më të hollë të reve
- B) Rrymat oqeanike
- C) Hijen e Hënës
- D) Natën



5. Në sa zona orare ndahet Toka?

1 pikë

- A) 12
- B) 16
- C) 20
- D) 24

6. Është rrjedhojë e përmasave të Tokës:

1 pikë

- A) Madhësia e forcës së gravitetit
- B) Forma e orbitës së Tokës
- C) Largësia nga Dielli
- D) Zonaliteti i dukurive gjeografike

7. Cunamet ndodhin si pasojë e lëvizjeve:

1 pikë

- A) epirogjenike
- B) luhatëse
- C) sizmike
- D) eustatike

15. a) Dukuritë vullkanike janë të rrezikshme për jetën dhe ekonominë e shoqërisë njerëzore.

Pavarësisht kësaj, vihet re se zonat pranë tyre janë tepër të populluara. Argumentoni përgjigjen.

1 pikë

b) Renditni dy nga mënyrat sesi mund të shfrytëzohen produktet vullkanike nga shoqëria njerëzore. 2 pikë

1. _____

2. _____

16. Pozicioni gjeografik është një nga temat bazë në gjeografi. Përcaktoni dy mënyrat se si mund të shprehet ai dhe shpjegoni njërin prej tyre.

3 pikë

17. Si formohen liqenet karstike?

3 pikë

Cili është ushqimi kryesor i tyre?


Ku gjenden në vendin tonë?

18. Lumenjtë formojnë tipe të ndryshme grykëderdhjesh. Shkruani tipin e grykëderdhjes së lumit në figurën e mëposhtme dhe argumentoni faktorët që ndikojnë në krijimin e saj.

3 pikë

Tipi i grykëderdhjes: _____

Argumenti: _____



19. Analizoni faktorët që kanë ndikuar në rritjen e popullsisë së Rajonit Perëndimor pas vitit 1990.

3 pikë

20. Sa është koha lokale e Ankarasë me gjatësi gjeografike lindore 33^0 , kur në Tiranë me gjatësi gjeografike lindore 20^0 , koha lokale është $13h05'$.

4 pikë